



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



## **MEMO SQARUESE LIDHUR ME DRAFT RREGULLOREN PËR PRONËSINË DHE KONCENTRIMIN E OSHMA-VE**

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) në mbledhjen e mbajtur me datën 21 dhjetor 2018, vendosi që në respektim të nenit 8 të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, të shpall për diskutim publik Rregulloren për Pronësinë dhe Koncentrimin e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale.

KPM, me qëllim të plotësimit të infrastrukturës ligjore në lidhje me rregullimin e Ofruesve të Shërbimeve Mediale dhe duke u bazuar në nevojën e rregullimit të tregut medial në Kosovë, ka iniciuar procedurën e hartimit të Rregullosës për Pronësinë dhe Koncentrimin e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale.

Me këtë draft-rregullore synohet vendosja e standardeve lidhur me pluralizmin dhe diversitetin e mediave, transparencën në pronësinë e mediave, duke përcaktuar rregullat për koncentrimin e pronësisë në media, parandalimin e monopolit në tregun medial, ndalimin e dominimit dhe presionit mbi mediumet, lirinë e shprehjes, ruajtjen e pavarësisë editoriale dhe të drejtën e informimit objektiv në harmoni me legjislacionin vendor si dhe praktikatat më të mira evropiane.

KPM, duke e ditur rëndësinë e rregullimit të pronësisë në media dhe krijimit të një tregu medial pluralist, ka përgatit këtë draft fillestar të cilën e prezanton për të shërbyer si bazë drejt një procesi të një konsultimi më të ngushtë edhe në baza individuale me palët e interesit të sektorit audiovizual dhe me institucionet përkatëse. KPM vlerëson rëndësinë e theksuar të rregullimit dhe transparencës së pronësisë prandaj për këtë draft rregullore ka vendosur që diskutimi publik të jetë në proces për një periudhë 90 ditë kalendarike nga data e vendosjes në diskutim publik, konkretisht deri me datën 31 mars të vitit 2019.

Gjatë kësaj kohe të dedikuar për konsultim publik, KPM do të realizojë takime të veçanta me të licencuarit, do të bëjë analiza shtesë të nevojshme duke marrë në konsideratë edhe gjendjen reale të tregut medial në Kosovë.

KPM e vlerëson shumë kontributin e dhënë nga të licencuarit e vet dhe inkurajon të gjithë që të ofrojnë komentet dhe sugjerimet e tyre në lidhje me këtë draft-rregullore me qëllim që të sigurojmë bazë të qëndrueshme ligjore në favor të pluralizmit medial.

26 dhjetor 2018

**Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM)**